



Nga ideja deri tek themelimi, ja kush është Akademia Profesionale Elita

Pasioni, sfidat, debati që karakterizon
këtë akademi të veçantë në Shqipëri

[faqe 2](#)

Jeta e përditshme tek Akademia. Leksioni, sfidat dhe prapaskenat e Elitarëve

Prapaskenat e elitës
në pak foto, për të
kuptuar momentet
e paharrueshme, të
veçantat dhe risitë
e akademisë më të
mirë në Shqipëri



[faqe 7](#)

NË BRENDESI

Vlerësime

NGA XHOXHI GJOKA
NGA SARA ÇELA
NGA ZENEL BAHITI
NGA EVA DAUTI
NGA ERVIS LILA
NGA GERTI SONO
NGA ROMINA SELENICA
NGA MELEQE BOCAJ
NGA JETON SKËNDERI

Afati i fundit për aplikim është data 20 tetor 2015. Për të marrë çdo informacion mbi programet, lëndët, etj, klikoni pranë www.elitaacademy.com


KANË FILLUAR APLIKIMET PËR "MENAXHIM BIZNESI"

E ARDHMJA JU AJ DREJT SUKSESIT



APLIKO TANI
WWW.ELITACADEMY.COM

Sfida e rradhës për Elitën politike nr.6;themelimi dhe lancimi i një partie



[faqet 5-6](#)

Planifikimi Financiar, një ndër lëndët më të rëndësishme për çdo menaxher

Është shumë thelbësore
të kuptohet në
mënyrë të qartë ideja
e financës dhe rëndësisë
së saj në jetën e
përditshme. Financa
si shkencë na rrethon
dhe shoqëron në çdo
moment të jetës sonë.
Çdo ditë ne...



[Nga Armand Hamza](#)

[faqe 10](#)

Diplomaci dhe marrëdhënie diplomatike

Bota e sotme pëson
vazhdimisht ndryshime
të një rëndësie
shumë të madhe.
Arena ndërkombëtare
është vazhdimisht e
levizshme dhe lind
nevoja për të qenë
i informuar në kohë
reale. Është esenciale
që të mësohet...



[Nga Ervis Sulejmani](#)

[faqe 9](#)

OPINION...

Menaxhimi i fushatave elektorale

Trajtohet në të dy
nivelet e degës së Elitës
Politike. Në nivelin e
parë, "Njohës i Politi-
kave", menaxhimin e
fushatave elektorale
e kam strukturuar në
koncepte të ...



[Nga Erindi Bejko](#)

[faqe 10](#)

"Aftësitë e Menaxhimit", "Sipërmarrja, Krijimi & Menaxhimi i biznesit";

Procesi i vendimarrjes
për të qenë pjesë e aka-
demisë, e kësaj platform
dinamike, ku vërehet
gjithmonë një impenjim
dhe përkushtimin maksim-
al...



[Nga Redinela Hoxha](#)

[faqe 10](#)

Situata politike...

Një analizë e përciptë shtator
2013-tetor 2015

[Nga Dritan Shehu](#) [faqe 12](#)

Situata e vendit nga sytë e të
rinjve shqiptar

[Nga Aleksandër Baboci](#) [faqe 12](#)

DREJT KUJT PO SHKOJMË

[Nga Shkëndije Çaça](#) [faqe 14](#)

Situata ekonomike...

"Për Procedurat Tatimore në
Republikën e Shqipërisë"

[Nga Murat Kllloçishta](#) [faqe 11](#)

Ekonomia shqiptare

[Nga Ledia Canga](#) [faqe 11](#)

Punësimi i të rinjve:
Problemi dhe zgjidhja

[Nga Ermal Nazifi](#) [faqe 12](#)

Lista e miliardërve: Çilët janë
njerëzit më të pasur në planet?

Të arrish një miliardëshin
nuk përbën një garë,
por disa e arrijnë atë më
shpejt se të tjerët. Revista
"Forbes" ka hartuar listën e
miliarderëve të...



[faqe 9](#)

rreth akademisë



Idejimi, fillimi deri tek themelimi i Akademisë Profesionale Elita

LICËNSIMI



“Akademia Profesionale Elita” filloj si një kurs vetëm në degën politike për përgatitjen e një grupi qytetarësh me mentalitet të ri dhe me objektiv kryesor aktivizimin e tyre me politikën shqiptare.

Kursi arriti një sukses të dukshëm, ku në pjesën e saj të parë, aftësoj si lider të epokës së re rreth 130 individ në total, në shkollën “Elita Politike” nr.1. Më pas u zhvilluar shkolla “Elita Politike nr.2” dhe para pak kohësh u mbyll me rezultate të shkëlqyera edhe “Elita Politike” nr.3.

Qëllimi ynë për promovimin e një grupi njerëzish të rinj, jo thjesht nga mosha, por mbi të gjitha nga botëkuptimi, u realizua me sukses të vërtet.

Pjesa më e madhe e pjestarëve të “Elitës Politike” përpara se të fillonin këtë shkollë, ishin thjeshtë individ me dëshirë për t’u bërë pjesë e jetës politike shqiptare por pas mbarimit të kursit të gjithë liderat filluan t’a shikojnë Shqipërinë si pjesë të familjes evropiane.

Pjestarët e shkollës së Elitës politike përparuan dhe u zhvilluan dukshëm në debate, oratori, informacion politik, por mbi të gjitha, u bënë pjesë e botës së politikës reale shqiptare.

Përveç teorisë dhe debateve kursi i “Elitës Politike” u shoqërua me praktika dhe sfida në terren, ku pjestarët u aftësuan me praktikën politike gjatë tre mujorit të kursit.

Të ftuarit kanë qenë të shumtë, nga bota e politikës, bota e shoqërisë civile, bota e biznesit por edhe fusha të tjera.

Praktika u realizua në disa kategori dhe fusha, pjesëmarrësit u aftësuan në ndërtimin e një projektligji, në organizimin e aktiviteteve të ndryshme partiake, në realizimin e konferencave për shtyp, në realizimin e aksioneve protestuese dhe një sër fushash të tjera.

Kursi i shërbeu pjestarëve të saj për t’u formuar plotësisht në sferën politike por dhe si qytetar të cilët duhet të besojnë të dëshirojnë dhe të kontribuojnë për t’a parë Shqipërinë pjesë të familjes së madhe evropiane.

“Elita Politike” ka tashmë 4 vite që është pjesë e shoqërisë shqiptare dhe pjesë shumë e rëndësishme e politikbërjes në Shqipëri, ne përgatisim të rinjtë për t’u bërë pjesë e asaj rrugë që ata aq shumë dëshirojnë, pjesë të politikës së Shqipërisë por jo si njerëz, por si lidera të denj për të qenë pjesë e saj.Me kalimin

e viteve “Elita Politike” u specializua dhe u përgatit akoma më shumë për të përgatitur elitën e politikës sonë aktuale.

Tashmë është krijuar “Akademia Profesionale Elita” ku në brendësi të saj është dega “Elita Politike” dhe “Elita e Biznesit”, me shumë pedagog të përgatitur, instruktor praktike dhe këshilltar të specializuar, janë bërë pjesë e kësaj strukture plot vlera.

Vitet e eksperiencës çdo ditë e më shumë në specializojnë për të përgatitur tashmë jo vetem liderat shqiptar por dhe lidera për rajonin tonë.

Zyra e karrierës është shtuar si një vlerë e kësaj akademie dhe që udhëton paralelisht me politikën shkollore për të përgatitur dhe më pas për të lanuar e për t’u kujdesur vazhdimisht për liderat që ne përgatisim.

Praktikat më të mira amerikane dhe europiane janë bërë pjesë e akademisë sonë për të përgatitur liderat tanë sipas mënyrave dhe metodologjive më të avancuara.

Ju pranë akademisë do të keni mundësi të shumta për të filluar rrugën tuaj te karrierës në profesionin përkatës. Nëse doni të bëheni elitë në politik



“Akademia Profesionale Elita” është themeluar me vendim gjykate nr.909 te gjyqtarës Arjana Lico e Gjykates se rrethit gjyqësor Tirane me qëllimin e realizimit të shkollave të të gjithë niveleve të arsimit parauniversitar, universitar, pasuniversitar, shkollave profesionale, kurseve të ndryshme. Akademia do të shërbej dhe si qendër studimesh në fusha të ndryshme.

“Akademia profesionale Elita” është paisur nga drejtoria rajonale tatimore me nr.NIPT-I: L41917452U
Është Liçensuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (Qendra Kombëtare e Liçensimit) me nr.license: LN-8372-08-2014
Dhe Liçensim nr.prot.4221 nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

KUSH JEMI

“Akademia Profesionale Elita”është një shkollë akademike profesionale.

Akademia ka dy degët e saj kryesore, përkatësisht “Elitën e Biznesit” dhe “Elitën Politike”.

Të dyja degët përbëhen nga petagog dhe instruktor/këshilltar praktike, shumë të përgatitur dhe me një eksperiencë të konsiderueshme në jetën publike por dhe konkretisht në fushën përkatëse.

Pjesë e pandarë e degëve tona profesionale është dhe praktika, ajo çfarë nga ne cilësohet dhe një

nga pikat e forta të akademisë.
Zyra e karrierës është një shoqërues i elitave tona që në momentin kur bëhen pjesë e shkollës dhe deri sa ato të jenë lidera të vërtetë në shoqërinë tonë, ndërmjet kësaj zyre ne bëjmë një ndërlidhje të tregut te punes ose atij politik për kurset politike dhe studentëve tanë.
Ambientete mësimi janë ndër më bashkohoret në tregun tonë.

Ju pranë akademisë do të keni mundësi të shumta për të filluar rrugën tuaj te karrierës në profesionin përkatës. Nëse doni të bëheni elitë në politik

dhe lider i ri, merrni pjesë në “Elita Politike” në degën profesionale të vetme të këtij lloji në Shqipëri. Nëse doni të bëheni specialist i ekonomisë, menaxher biznesi, specializohuni duke marrë pjesë në “Elitën e Biznesit”.
Ne do ju shoqërojmë shumë gjatë, ne do të krenohemi me ju dhe ndërmjet politikave tona zhvilluese, do të mundohemi t’ju hapim rrugët e karrierës suaj, por ju jeni ata që duhet të punoni e të përkushtoheni për këtë pjesë.

Me ne në krah, ju do të bëheni ELITA E SHQIPËRISË!

rreth akademisë



Prijoritetet dhe zyra e karrierës

“Akademia Profesionale Elita” ka prioritet të saj përgatitjen dhe nxjerrjen e studentëve tanë në tregun e punës dhe tregun politik për Elitën Politike por dhe ndjekjen e karrierës së tyre hap pas hapi.

Zyra e Karrierës kryen një sërë funksionesh të lidhura ngushtësisht me ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve por dhe pas tyre të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes për t’u integruar lehtësisht në tregun e punës, por dhe në tregun politik për degën e politikës, me ndjekim dhe kujdesemi për studentet dhe pas studimeve pranë akademisë.

Zyra e karrierës ndjek dhe organizon çështjet e karrierës të studentëve; Ofron këshillim dhe udhëzime në lidhje me orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; Bashkëpunon ngushtë me departamentet e degëve përkatëse për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve; Mban komunikim me Bordet e Tregut të Punës për të tërhequr mendime sa i takon përputhjes së certifikatave të ofruara, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave; Është përgjegjëse për organizimin e panairëve të punës; Mban marrëdhënie të vazhdueshme me partitë politike në Republikën e Shqipërisë shoqatat, kompani apo organizime të tjera dhe i mbështet ata në funksionimin e tyre.



Ambientet e akademisë



Akademia Profesionale Elita është shkollë profesional, e cila ju përgatit konkretisht për profesionin që ju do të zgjidhni sipas dëshirës. Akademia Elita me anë të leksioneve dhe praktikës ju aftëson për një karrierë të sigurtë dhe të suksesshme. Tek ne praktika ka rol shumë të rëndësishëm. Akademia Profesionale Elita është vlerësuar nga një numër i madh institucionesh dhe personalitetesh...

Mos humbisni kohë!

- 👍 Cilësi, leksione të domosdoshme dhe praktikë që ju aftëson.
- 👍 Pajisni me certifikatë të njohur nga shteti shqiptar.
- 👍 Vazhdueshmëri dhe karrierë të sigurtë.



“Akademia Profesionale Elita” ka realizuar një klip muzikor në të cilin renditëshin mesazhe të ndryshme drejt shoqërisë. Ky klip është realizuar totalisht nga studentët e akademisë dhe është transmetuar në kanalet muzikore.

Klipi duke u transmetuar në kanalin muzikor BBF.




Humoristi i njohur, Julian Deda, selfie me studentët

Promovimi

“Akademia Profesionale Elita” në të gjithë degët e saj, realizon promovimin e studenteve në mënyra dhe mjete të ndryshme, në mënyra publike por edhe mënyra të tjera efçente.

Ne e shoqërojmë studentin jo vetëm gjatë kohës së studimit por dhe pas kësaj kohe.

Në këtë kategori keni disa ilustrime të promovimit të pjesëmarrëve nëpër mediat më prestigjioze dhe më të mëdha shqiptare në: Vizion +, Tv Klan, Top Channel, TVSH, ABC news al report, utv, gazeta Shekulli, agjensi online, etj.



“Rinia për ndryshim”

Filluan aplikimet



Ja pse “Menaxhimi i Biznesit”, është dega që i duhet çdo individ

Për degën "Menaxher Biznesi" filluar aplikimet, nxitoni!!!

kliko dhe apliko

Dega Menaxhim Biznesi

“Menaxhim Biznesi” është një degë 5 mujore e “Akademiës Profesionale Elita” ku zhvillon mësim 1 herë në javë. Akademia Elita është arsim profesional. Në mbarim të kësaj dege do të çertifikoheni si “MENAXHER BIZNESI” të njohur nga shteti shqiptar. Akademia jonë është e përbërë nga dy departamente kryesore “Elita e Biznesit” e cila konsiston në përgatitjen e menaxherëve të biznesit dhe dega “Elita Politike” ku konsiston në përgatitjen e politikanëve dhe liderave të rinj në politikë.

Kjo lloj shkolle profesionale hapet për herë të parë në Shqipëri. Në shkollën tone profesionale nuk mund të marrin pjesë të gjithë individët, por të gjithë pjestarët që kanë dëshirë të aplikojnë ndërmjet një formulari aplikimi dhe bordi përzgjedhës i shkollës përzgjedh aplikimet më të vlefshme. Jo të gjithë individët që aplikojnë pranohen. Kjo realizohet për të siguruar një cilësi në mësimdhënie dhe arritjen e objektivave përkatëse.

Pas mbarimit të kësaj dege ju mund të ushtroni në vazhdim profesionin e MENAXHERIT TË BIZNESIT në biznese private, shtetërore, në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara (SH.P.K), shoqëri aksionare (sh.a) apo të menaxhoni një biznes tuajin të çfarëdolloj forme juridike.

Mos humbisni kohë!



Profesioni

Menaxher biznesi i njohur nga shteti shqiptar



KOHËZGJATJA

KU ZHVILLOHET

VISA TARIFA

DEGA profesionale “Menaxher Biznesi”

Kohëzgjatja e degës: 5 muaj. Leksionet por dhe praktika do zhvillohet të shtunave. Leksionet zhvillohen një herë në javë, ditën e shtunë, në orën 15:00-19:00.


Më shumë info

Ju do të aftësoheni në anën juridike mbi menaxhimin juridik tek një kompanie, aftësitë menaxheriale tuajat do të rriten, ju do të dini si të hartoni një plan biznesi, si të realizoni një aplikim kredie të suksesshem, të menaxhoni dhe të planifikoni fillimin vazhdimin dhe mbarvajtjen e biznesit tuaj apo të biznesit që drejtoni, do të aftësoheni të mbani vete financat e biznesit tuaj, të deklaroni blerjet, shitjet, sigurimet, të plotësoni faturat, etj.

Ju do të zhvilloni oratorinë tuaj por do të zhvilloni dhe fuqinë tuaj marketuese për të realizuar fushata të ndryshme marketuese ose për të shitur produktet tuaja. Ju do të aftësoheni si të menaxhoni burimet njerëzore brenda kompanisë por dhe të bëheni më social në biznesin tuaj.

Por një nga pikat më të rëndësishme është së çfarë do të mësoni në ciklet e leksioneve, ju do i vini në praktikë ndërmjet praktikës së biznesit që do të realizohet nga akademia por dhe në bashkëpunim edhe me biznese të ndryshme. Akademia Profesionale Elita ndërmjet zyrës së karrierës do të ndihmojë studentët dhe do i orjentoj si gjatë kohës së shkollës por dhe pas mbarimit të saj. Ne do të realizojmë dhe lidhjen e studenteve me biznese të ndryshme shqiptare e të huaja, ku studentët mund

të punësohen në këto kompani. Në mënyrë të vazhdueshme zyra e karrierës pranë akademisë do t’i ofroj bizneseve për t’i punësuar studentët tanë. Zyra e karrierës do të luaj dhe rolin e zyrës së punës ndërlidhëse. Akademia në mënyrë të vazhdueshme dhe pas ciklit të studimeve që ju do të realizoni pranë nesh, do të kryej konferenca biznesi ku do të ftoj dhe do të ketë në epiqendër të saj studentët e akademisë, promovimin e tyre, dhënien e mundësisë studentëve dhe ish-studentëve për t’u bërë pjesë e strukturave të ndryshme ekonomike dhe të biznesit, në privat por dhe shtet. Ndërmjet këtyre konferencave por dhe aktiviteteve të tjera të vazhdueshme ne do të vazhdojmë pasurimin e dijeve ekonomike për studentët dhe ish-studentët tanë.



Sfida, Elita Politike

AKADEMIA PROFESIONALE ELITA

Sfida e rradhës për “Elitën Politike” nr.6; themelimi dhe lancimi i një partie

Çdokush nga ne i vendos vetes disa qëllime në jetë. Disa e shohin shkollën si vendin i cili do t'i përgatisë për të qenë nesër lidera në fushën që kanë zgjedhur. Po a mjafton vetëm ana teorike për tu përballur nesër me tregun e punës? Normal që jo. Akademia Profesionale Elita është nga të vetmet institucione arsimore që ka realizuar një ndërthurje perfekte të teorisë me praktikën dhe këtë mund ta përmendim si një ndër pikat më të forta të shkollës sonë. Të gjithë studentët e Elitës së Biznesit

dhe Elitës Politike dhe ndahen në grupe, të cilët realizojnë sfida duke qënë në konkurrencë me njëri tjetrin. Studentët e Elitës së Biznesit me anë të lëndës së praktikës vendosin në jetë njohuritë që kanë marrë në aspektin teorik... Ata marrin përsipër të realizojnë një plan start up për hapjen e një biznesi, organizojnë evente fitimprurëse, ata vendosin përballë sfidave ku secili nga grupet arrin më shumë fitime nga shitja dhe marketimi i produkteve apo shërbimeve përkatëse. Temat në praktikën e biznesit

vendosen nga bordi i praktikës. Këto tema janë totalisht praktike ku vënë studentet në moto për të realizuar praktikisht praktikën e biznesit. grupet renditen nga grupi më i mirë tek grupi më i dobët për sfidën përkatëse (psh sfidat kanë ngjashmëri me sfidat praktike tek emisionit “Donald Trump”. Këto sfida japin dhe edukatën e punës në grup, kanë një rëndësi shumë të madhe në të gjithë procesin e zhvillimit të degës, etj Studentët e Elitës Politike me anë të lëndës së praktikës aftësohen sesi të punojnë në

grup, sesi të drejtojnë një grupim individësh, sesi të organizojnë një aktivitet (marshim, tubim, aktivitet kulturor sportive ose social). Studentët me anë të sfidave mësojnë sesi të hartojnë një projektligj, sesi të përhapin sa më shumë një slogan qoftë ai politik ose jo, cilat janë hapat që ndiqen për të krijuar një parti politike, sesi të hartojnë një platformë politike, si të fitojnë përkrahje dhe sesi të fitojnë mbështetje. Çdo sfidë e kanë surprizë nga bordi dhe studentët tanë e realizojnë secilën në kohë rekord brenda një jave. Praktika

është një nga lëndët e preferuara të studentëve dhe përveçse i aftëson në anën praktike i socializon me njëri tjetrin dhe në përfundim të shkollës mbeten edhe miq shumë të mirë. Madje shumë prej tyre shprehin se praktika u ka bërë të marrin pjesë në aktivitete që as që i kanë menduar ndonjëherë. Të gjitha organizimet që përmenda më sipër janë realizuar deri më sot nga studentët tanë... Ju ftoj të bëheni pjesë e Akademisë Profesionale Elita sepse kjo eksperiencë është e paharrueshme.

Grupi 1 KOSTALDA VISHA KOORDINATORE

Gjithçka nisi ditën e parë të shkollës kur u hodh shorti në të cilin të gjithë studentët u ndanë në dy grupe. Prej disa vitesh unë jam koordinatore e praktikës për Grupin 1. Sapo u përcaktuan anëtarët e grupit tim unë hapa një grup sekret në FB ku i shtova të gjithë. Javën e parë secili nga studentët bëri një prezantim të vetes. Në disa momenta mendova bobo shumica e grupit tim jeton jashtë Tirane dhe ndoshta do e bëj më të vështirë organizimin e sfidave por më vonë kuptova që largësia nuk na prishte aspak punë... Pashë një grup ku studentët kishin studiuar ose vazhdonin studimet në fusha të ndryshme dhe kjo më gëzoi. Javën e dytë të shkollës u dha sfida e parë e cila ishte:

- Secili nga grupet do jetesoj ne veprime nje parti reale
- Secili nga grupet:
 1. do zgjedhi emrin e partisë (emri partisë nuk mund të jetë i njëjti me parti reale që ekzistojnë sot në Shqipëri)
 2. do realizojnë objektivin dhe qëllimet dhe pikësynimet e partisë (mini platformë)
 3. realizimi i një plani për publicitetin e partisë dhe objektivave të saj
 4. ekzekutimi i planit të publicitetit në terren.

Nga grupi 1 dolën 7 kandidatë për kryetar grupi. Në fillim u stapa pak sepse nga eksperiencia të mëparshme nëse ka shumë kandidatë më pas lindin edhe probleme por fatmirësisht nuk ndodhi me këtë grup. Pasi secili prej kandidatëve dha arsyet pse duhet ta votonin, antarët e grupit 1 zgjodhën me shumicë votash Jetonin si kryetarin e kësaj sfide.. Që në ato moment pash pash një dëshirë të gjithë antarëve të grupit për të bashkëpunuar dhe për ta realizuar sfidën sa më mirë. Puna filloi që atë darkë ku secili nga antarët e grupit hodhi propozimet e veta për emrin e partisë. Ditën e diel pasditë kishim 40 alternativa nga të cilat me votë grupi vendosi

DISA FOTO NGA SFIDA



Grupi 2 EVI NAKU KOORDINATORE

Momenti më i përshtatshëm për të folur lidhur me praktikën mësimore ose siç e quajmë ne sfidat. Ditën e shtunë na u komunikua sfida e parë për Elitën Politike, nivelin e 1. Kam kënaqësinë të jem koorinatore praktike për grupin nr 2. Ne ditën e nisëm bashkë në një kafe për të prezantuar njëri-tjetrin dhe për të krijuar një ide se kush mund të ishte i përshtatshëm për Kryetar sfide. Takimi paraprak ishte gjithashtu i domosdoshëm për të lidhur emrat, me fytirat dhe me emrat e tyre në facebook. Dashuri me shikim të parë me këtë grup sepse secili kishte diçka për të folur për veten por nuk u ngutën ta prezantonin veten. Momenti i lançimit të sfidës, kuriozitet për të gjitha palët. Sfida e javës një impenjim i jashtëzakonshëm me një grup të sapo prezantuar prej 50 vetësh. Elementi i dytë pozitiv, nga grupi im dolën 3 kandidat për kryetar, morra frymë thellë dhe mendova me veten - “nuk qenkan si ata vjet”. E shtuna u mbylll paqësisht për ne, Agimi, kryetari u zgjodh me 23 vota pro nga 27 të pranishëm, tërhoqi vëmendjen me prezantimin karizmatik të tij. Mbledhja e 1, të hënën në orën 20:00, për orarin nuk pati asnjë debat siç i ka ënda gjithmonë grupeve mos të bien dakort. Deri këtu situata përrallore. Mbledhja jonë e parë zgjati 90 minuta nga e cila dolëm, pa emër dhe pa asnjë plan konkret. Ishte shumë e bukur për të qenë kaq e lehtë. Çdo energji imja, çdo mendim ishte fokusuar në zgjidhjen e kësaj situatë dhe nuk po kuptoja ishte nga mungesa e eksperiencës së tyre në terren apo mos kisha lënë unë diçka pa shpjeguar. Zgjidhja e parë ishte ndarja e grupit të madh në minigrupe pune. Sinqerisht nuk kam parë njerëz më të edukuar dhe me dëshirë të madhe për të dëgjuar. Për mos të hyrë shumë në detaje të javës dua të përmend vetëm ditën e mërkurë një nga minigrupet kërkon mbledhje për të diskutuar disa detaje ekzekutimi dhe

VAZHDON>

VAZHDON>

Sfida, Elita Politike



<<VAZHDIMI

top 6 më të pëlqyerat. Ditën e hënë në orën 17:00 drejtori i shkollës realizoi mbledhjen me dy koordinatorët e grupeve dhe dy kryetarët për të dhënë udhëzimet për realizimin e sfidës. Në orën 17:30 grupi 1 realizoi mbledhjen e parë të grupit pranë zyrave të administratës së shkollës ku debatet ishin të shumta dhe me shumicë u vendos emri i partisë “NISMA PËR SHQIPËRINË”. Pikën e parë e mbyllëm me sukses dhe filluam punën për hartimin e miniplatformës. Studentët u ndanë në minigrupe dhe punuan deri ditën e mërkurë për shtyllat kryesore ku do bazohej platformën: -arsimi -rinia, -drejtësia, -ekonomia, -mjedisi.

Po ditën e hënë në fb u hap një fanpage me emrin dhe logon e partisë dhe përkrahja rritej çdo ditë. Që nga ajo ditë antarët e grupit vendosën logon e partisë si foto profile në fb e tyre personale në mënyrë që publiciteti të zgjerohet. Nga ajo ditë që u hap fanpage e çdo ditë që vijojë faqa ishte aktive me foto, video ku qytetarë të shqipërisë mbështesin këtë parti. Por mbështetja erdhi dhe nga shqiptarë që jetojnë kudo nëpër botë.

Në mbledhjen e të mërkurës vendosëm planin e publicitetit dhe sesi do ta ekzekutojmë. Kishte shumë debate, mendime të ndryshme, individë që dëshironin të ishin në fokus të disa daljeve publike dhe pas tre orësh ja dolëm mbanë. Po ditën e mërkurë tre nga antarët e grupit prezantuan këtë nismë në emisionin e mbremjes në Radio Nacional. Të enjten ditën e sfidës së madhe të kombëtares sonë të futbollit kundër serbisë grupi bëri një zgjedhje interesante, së pari për të dalë si parti në mbështetje të cunave të dhe së dyti për të realizuar publicitetin në terren të emrit të partisë dhe platformës. Nën tingujt e këngëve patriotike me qindra qytetarë mbështetën nismën e grupit tonë. Grupi i pranishëm në terren shpërndanë fletushka ku qytetarët u njohën me partinë dhe platformën dhe shumë prej tyre bënë edhe foto në mbështetje të Nisma për Shqipërinë... Ditën e premte disa nga antarët e grupit paradite doli ne terren në takime me qytetarët për të shpalosur platformën dhe për të marrë mbështetje nga qytetarë të shumtë por edhe disa personalitete të fushavë të ndryshme. Dita e shtunë erdhi, dita e ekzekutimit të sfidës.

Një ditë me shumë shi por ne ja dolëm, sfiduum motin, qëndruam aty deri në përfundim sepse këtë gjë do të bënte çdo parti reale nëse do të ishte në fushatë. Organizuam një ambient të këndshëm me muzikë në sfond, dy tavolina të pozicionuar në zonën e Tajvani dhe një super grup i cili u ndanë disa minigrupe: Në zonën e tavolinës kishim vendosur tabakë me logon tonë dhe a4 në të cilat me qindra qytetarë firmosën për të na mbështetur dhe nuk mungonin as fletushkat të cilat paraqeshin objektivat, qëllimet dhe platformën tonë. Grupet e tjera të studentëve bënë publicitet partisë dhe merrnin mbështetje nga qytetarët në zonën e Myslym Shyrit, Bllokut dhe përballë Piramidës. Por sfida jonë nuk u mbyll këtu, nuk u mbyll të shtunë. Gjatë javës që pasoi të gjithë antarët e grupit filluan të merrnin mbështetje në të gjithë Shqipërinë për Nisma Për Shqipërinë e përveç kësaj dhe figura publike na mbështetën me videoselfie të cilat i kanë publikuar në faqet e tyre me me mijra like. Ne si grup mendojmë që ja kemi dalë mbanë...

Unë si koordinatorë vlerësoj maksimalisht punën bashkëpunuese të grupit, individë të përgatitur, respektivisht njëri-tjetrit, marrin përsipër ti çojnë punët deri në fund, ngulmues për të arritur rezultate pozitive. Përpos sfidës ky grup është socializuar me njeri-tjetrit e jam e sigurtë që bashkëpunimi do vazhdojë edhe pas mbarimit të shkollës... Jam krenarë për grupin që koordinoj, jam krenarë që kam elemente kaq pozitiv e mbi të gjitha individë të cilët nuk dorëzohen përpara vështirësive... Jam e lumtur që për grupin tonë largësia nuk ekziston Tirana, Durrësi, Lezha, Mallakstra, Lushnja, Vlora, Elbasani, Librazhdi, Kavaja, Hasi, Peshkopia, Ferizaj dhe Gjilani jemi një të gjithë bashkë për NISMA PËR SHQIPËRINË... Të gjithë kanë punuar shumë pavarësisht kohës pavarësisht angazhimeve të tyre personale sepse të gjithë si grup besojnë se nëse përkushtohen suksesi do të vijë... Sic thonë edhe ata vetë “Ne jemi më të mirët”... Unë besoj që ata janë vërtet më të mirët... Le ta shijojmë këtë shkollë maksimalisht. Faleminderit njësha dhe suksese në rrugën tuaj...



VAZHDIMI>>

bien dakort për në orën 22:00, uau! Ishte hera e parë që ndjeva se isha më shumë e rritur nga çfarë mendoja se mund të përballoja, por në sekondin e dytë u ngushëllova, kisha Altinin në grup. Ditën e enjte kishim aktivitetin e parë, një rrëmujë nëpër rrugëm një rrëmujë sa gjetëm njëri-tjetrit dhe një siklet deri sa të mund të ekzekutonim idenë e takimit të qytetarëve në terren për të ngjitur një logo me “Dua më shumë Shqipërinë”, në një atmosferë tifozerie, 20 minuta përpara ndeshjes Shqipëri – Serbi. Kishte dy anë, një njerëz sa të duash që mund të arrihej qëllimim por dhe një feedback mbase jo i mirë për shkak të orarit. Çdo gjë doli shumë bukur, pamë ndeshjen të gjithë bashkë dhe normalisht bisedat vazhduan deri në orët e para të mëngjesit në messenger.

Ditën iknin dhe ishte sfida e parë, në jetën time që nuk më ka interesuar fare se çfarë po bën gruoi tjetër, dua tju them që këtë qetësi menaxhimi të sfiduesit ma mësoj vetëm ky grup. Nuk kanë diskutuar për asnjë çast shtoni like-t te funpage sepse u afruan, apo u larguan apo na e kaluan... Thirrje që të bëheshin kolonë zanore. Me kaq shumë mirëkuptim dhe qetësi erdhëm në ditën e shtunë që prisnim të konkretizojmë aktivitetin e madh por nuk mundëm sepse binte një shi i jashtëzakonshëm. Ndërkohë që endesha lart e poshtë nëpër Hotel Tirana International, mendja ime punonte vetëm çtë bënim që të gjithë studentët që kishin ardhur nga rrethet apo Kosova të merrnin pjesë në një aktivitet sepse kishin bërë kilometra dhe sdo mund të ishin gjatë javës. Paralelisht me pamjen time totalisht të stresuar, te kullat qëndronte shtatëllart dhe syptatrembur Agimim përsëriste dhe përsëriste se ai e kishte fituar sfidën e tij. Me veten time thoja duhet ti kisha thënë që ti linte shakat sot sepse është shumë e rëndësishme të dalim mirë, por në fakt nuk kisha patur asnjë mundësi tja thoja sepse kisha qeshur pafund dhe vetë, shkruaj te grupi i ekzekutimit që duhej jetur një zgjidhje...

Ishte shiu litar dhe grupi që e kishte marr shumë lehtë! Aktivitetin e kishim shtyrë ora po a fronte, grupi ekzekutimit ishte në vendin e aktivitetit i kishin mbledhur kolegët e tjerë të grupit dhe po vazhdonin të më thonin: “Ne kemi fituar sfidën” “Jemi ul këtu kur të shkoj ora do ngrihem dhe organizohemi” dhe ndërkohë që shiu binte...

Llampa u ndez! I them grupi të ekzekutimit, do improvizojmë mbledhje me delegatët në të gjithë Shqipërinë dhe Kosovë dhe në këtë takim përfundonim dhe platformën të cilën do ta bëjmë publike gjatë aktivitetit të madh ditën e martë meqenëse u shtyjë, u them, - kemi zyrën e administratës apo te “Melody” bar? - Përgjigja pastër dhe saktë – “te melody, ka parkim, është më afër” - etj etj - “mblidhemi dhe ikim atëherë”.

Në mes të një shiu, dolëm te vëllezrit Farshëri të mblidhnim grupin, u ndamë nëpër makina dhe si partizanë u gjendëm te “Melody” ngrohtë dhe të siguruar se diçka shumë e bukur dhe më e mirë na priste ditën e martë...

Dita e martë e javës së dytë ne organizuam një aktivitet të jashtëzakonshëm te Sheshi “Nënë Tereza”, me një band muzikore dhe birra. Kemi mbledhur shumë njerëz sa nuk mund ta kishim parashikuar dhe jemi kënaqur. Aktiviteti i kaloj pritshmëritë e asaj që kishim menduar dhe falenderojmë shiun që na e spostoj aktivitetin.

Kam lënë shumë detaje të papërmendura për efekt hapësire në gazetë, por dua tju falenderoj pa masë për emocionet që më keni dhuruar gjatë kësaj jave... Keni shumë pë të dhënë dhe po aq shumë për të marr, si në sallat e 15-katëshit dhe në grupet e facebook-ut. Jeni më të mirët dhe më të mirët fitonë gjithmonë, sfida është vetën beteja e kësaj jave!

Jeta e përditëshme

AKADEMIA PROFESIONALE ELITA

Disa foto rreth jetës së përditëshme e aktivitetit, tek Akademia Profesionale Elita

Prapaskenat e elitës në pak foto, për të kuptuar momentet e paharrueshme, të veçantat dhe risitë e akademisë më të mirë në Shqipëri





Kanë nisur aplikimet për degën "Menaxher Biznesi" ... [Apliko Tani](#)

Afati i fundit i aplikimeve është data 20 tetor 2015



Akademia Elita

Elita është akademia më e mirë në Shqipëri e njohur nga shteti shqiptar. Këtu do të përgatiteni dhe praktikoheni në profesionin përkatës.



Punësimi & karriera

Akademia Profesionale Elita ka pranë saj zyrën e karrierës. Kjo zyrë ju lidh me biznese apo me institucione të ndryshme ku ju mund të punoni.



Pedagogët & të ftuar

Stafi pedagogjik është tepër i përgatitur dhe me shumë eksperiencë. Orë mësimi realizojnë edhe persona të njohur publik.



Profesioni

Profesioni njihet nga shteti shqiptar. Pas certifikimit ju mund të punoni në profesionin përkatës. Pranë nesh keni mundësi për karrierë.

APLIKO TANI

PËR DEGËN

MENAXHIM BIZNESI

WWW.ELITAACADEMY.COM

Si mund të na kontaktosh:



Adresa e zyrave qendrore:

tek 9-katëshet, rruga "Qemal Stafa", 100 metra mbi qëndën "Lincoln"



Mob:

06802020 260 / 0697377 688



Email:

info@elitaacademy.com




Skype:

akademielita



Web:

elitaacademy.com




Evi Naku

koordinatore

Phone: 0697377688

Email: info@elitaacademy.com

Skype: akademielita



Kostalda Visha

koordinatore

Phone: 0682020260

Email: info@elitaacademy.com

Skype: akademielita

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM ËSHTË DATA 20 TETOR 2015

Lista e miliardërëve: Cilët janë njerëzit më të pasur në planet?



sikanin Carlos Slim, me 72 bilionë dollarë dhe Amancio Ortega me 64 milionë dollarë. Forbes e përlogarit pasurinë me anë të asetëve totale të pasurisë dhe kjo është një mënyrë e arsyeshme, duke marrë parasysh se bilionerët e sotëm kanë një pasuri globale. Mirëpo duhen konsideruar edhe dallimet gjeografike.

A është vërtet Bill Gejts personi më i pasur në botë? Këtë pyetje ka ngritur kërkuesi Branco Milanović, në përpjekjet e tij për të krahasuar pasurinë globale. Sipas tij, nëse Gejts i blen shumicën e të mirave dhe shërbimeve në ShBA, ndërsa Slim i konsumon ato në Meksikë, Slim mund të jetë më i pasur, pasi në Meksikë mund të bleh më tepër me një dollar.

Ai e përlogarit pasurinë e bilionerëve duke vlerësuar fuqinë blerëse kombëtare. Kjo mënyrë llogaritjeje e vendos Gejts në vendin e tretë, pas Slim dhe Ortega. Kjo për faktin se Gejts vërtet ka më tepër pasuri se dy të tjerët, por Meksika dhe Spanja janë vende më të varfra se ShBA.

Më poshtë jepet lista e 20 miliardërëve më të pasur në listën e Forbes. Sipas matjeve të Milanović, pamja paraqitet ndryshe.

10 më të pasurit:

- 1 Bill Gates \$76 mld / Microsoft SHBA**
- 2 Carlos Slim Helu \$72 mld / Telecom Meksikë**
- 3 Amancio Ortega \$64 mld / Retail Spain**
- 4 Warren Buffett \$58.2 mld / Berkshire Hathaway SHBA**
- 5 Larry Ellison \$48 mld / Oracle SHBA**
- 6 Charles Koch \$40 mld / Diversified SHBA**
- 6 David Koch \$40 mld / Diversified SHBA**
- 8 Sheldon Adelson \$38 mld / Casinos SHBA**
- 9 Christy Walton \$36.7 mld / Walmart SHBA**
- 10 Jim Walton \$34.7 mld / Walmart SHBA**

Të arrish një miliardëshin nuk përbën një garë, por disa e arrijnë atë më shpejt se të tjerët. Revista "Forbes" ka hartuar listën e miliardërëve të botës dhe kësaj here lista ka arritur rekorin prej 1645 njerëzish, duke përfshirë edhe 268 të rinj. Kjo listë përmban 42 gra. Nga 1645 anëtarët e listës së bilionerëve, 31 janë nën moshën 40 vjeç.

Grupi elitar nuk përfshin më djemtë e Google, Sergey Brin dhe Larry Page. Pasuria është shpërndarë në qoshe të reja të botës dhe ka përfshirë për herë të parë vende si Tanzania.

Sipas Forbes, Bill Gejts ndodhet sërish në krye të listës, me një pasuri prej 76 miliardë dollarë, duke kaluar kështu mek-

Disa lëndë dhe pedagogë

**ZGUA OLT
ZGUA VISHA**

PRAKTIKË FINANCIARE

Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme janë motorri i ekonomisë së një vendi. Në Shqipëri, ashtu si në pjesën tjetër të Evropës, rreth 97.7% të njësitë ekonomike janë të vogla dhe të mesme, duke krijuar një raport rreth 38 NVM për 1.000 banorë.

Të punësuarit pranë tyre zënë rreth 78% të krahut të punës duke kontribuar kështu në përgjegjshmërinë sociale të këtyre njësitë ndaj shoqërisë. Njësitë ekonomike pavarësisht madhësisë së tyre janë të detyruara të hartojnë pasqyra financiare dhe të përgatisin dhe dorëzojnë deklaratat tatimore.

Në këtë mënyrë lënda Praktika financiare ka për qëllim të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë praktike të pjesëmarrësve në fushën e mbajtjes së kontabilitetit dhe financave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe njohjen me legjislacionin tatimore të vendit.

Temat e trajtuara dhe rastet praktike do t'i sjellin siguri studenteve të angazhohen dhe të drejtojnë njësitë e tyre ekonomike.

**ZGUA ERVIS
ZGUA SULEJMANI**

**DIPLOMACI DHE
MARRËDHENIE DIPLOMATIKE**

Bota e sotme pëson vazhdimisht ndryshime të një rëndësie shumë të madhe. Arena ndërkombëtare është vazhdimisht e levizshme dhe lind nevoja për të qenë i informuar në kohë reale. Është esenciale që të mësohet edhe arsytet e këtyre ndryshimeve në mënyrë që shpjegimi dhe analiza e plotë e së shkuarës dhe së tashmes të bëjnë të mundur arritjen e përfitimeve në të ardhmen.

Liderat e rinj, për të cilët rajoni i Ballkanit ka kaq shumë nevojë, duhet të kalojnë disa programe formimi për të përgatitur ata për sfidat e së ardhmes. Për formimin teorik dhe praktik, Akademia Elita u vë në dispozicion studentëve një program shumë të pasur dhe profesional. Gjithashtu, njohuritë e fituara në Eliten Politike, nuk janë aktuale dhe të nevojshme vetëm për amjentet brenda klasës, por edhe për realitetin e jashtëm, për çka po i përgatisim studentët në të vërtetë.

Rishtazi, në Elitën Politike kemi shtuar lëndën e diplomacisë. Kjo risi vjen për të dhënë mundësi studentëve jo vetëm të fitojnë njohuri teorike dhe praktike për diplomacinë, por të jenë të aftë të komunikojnë dhe të orientohen lirshëm në një ambient internacional dhe multikulturor. Në ditët e sotme diplomacia zhvillohet në mënyra nga më të larmishmet dhe përgatitja multi-dimensionale e kandidatëve është e paevitueshme. Misioni im kryesor mbetet sjellja e njohurive dhe ekspertizës së fituar në institucione prestigjioze ndërkombëtare, si Akademia Diplomatike e Vjenës, dhe implementimi i tyre në shërbim të Akademisë Profesionale Elita dhe trupës studentore.

Gjithashtu, këtë vit akademik, me Eliten Politike 4/3 po zhvillojmë disa leksione lidhur me Çështje Aktuale Ndërkombëtare. Këto leksione kanë për qëllim informimin e studentëve mbi zhvillimet më të fundit politike, ekonomike, sociale e kulturore në arenën ndërkombëtare. Bashkëbisedimi dhe interaksioni janë bazat e këtyre leksioneve që tentojnë jo vetëm të informojnë studentët por edhe ti përfshijnë ata në keto tema. Një kombinim i mirë i informacioneve të reja me bashkëbisedimin dhe analizimin e këtyre çështjeve, sjell një përvetësim më cilësor të këtyre temave.

Akademia Profesionale Elita ka një grup studentor mjaft larmant, jo vetëm nga mosha, por edhe nga vlerat, ekspertizat dhe eksperiencat që ata mbartin. Njohuritë e tyre, aftësitë e tyre analitike dhe të menduarit kritik i diferencojnë dhe i bëjnë këta studentë të jashtëzakonshëm. Akademia Profesionale Elita do t'i pajisë këta individë me njohuri teorike dhe praktike vërtetë të vlefshme për të ardhmen e tyre.

Disa lëndë dhe pedagogë



NGA
**ARMAND
HAMZA**

PLANIFIKIMI FINANCIAR

Është shumë thelbësore të kuptohet në mënyrë të qartë ideja e financës dhe rëndësisë së saj në jetën e përditshme. Financa si shkence na rrethon dhe shoqëron në çdo moment të jetës sonë. Çdo ditë ne punojmë dhe jetojmë në një ambient dinamik ku rregullat e ekonomisë së tregut na diktojnë jo pak herë veprime apo vendime financiare. A jemi të përgatitur ti kuptojmë dhe interpretojmë këto rregulla me të cilat përballemi çdo ditë? A kemi njohuritë dhe dijet e nevojshme për të kuptuar gjithë dinamikën e botës gjithnjë e më komplekse të biznesit që na rrethon. Cilat janë nevojat e bizneseve tona? Si ndikohen sipërmarrjet dhe financat tona nga faktorët makro dhe mikroekonomike të tregut?

Lënda e "Planifikimit Financiar" ka për qëllim të japë përgjigje për të gjitha pyetjet e ngritura më sipër duke ilustruar çdo nocion apo argument financiar me detaje nga praktikat reale të biznesit vendas. Dizenjimi dhe analiza financiare gjatë përgatitjes së Planeve të Biznesit apo analizat e investimeve. Analiza e përdorimit të borxhit dhe financimi me borxh. Kredia si instrument financiar, kur dhe ku duhet përdorur ajo? Kostot e kapitalit që ndikojnë jetën e një biznesi dhe analiza e këtyre kostove në realitetin e biznesit në Shqipëri. Problemet e biznesit vendas dhe orientimi i Biznesit vendas drejt planifikimit financiar. Të gjitha këto detaje përbëjnë thelbin e nocioneve dhe tematikave që "Planifikimi Financiar" si lëndë synon të paraqesë në mënyrën më origjinale dhe praktike në kushtet e tregut dhe faktorëve ekonomike që ndikojnë në vendimet dhe sipërmarrjet tona financiare.

NGA
**REDINELA
HOXHA**

"AFTËSITË E MENAXHIMIT", "SIPËRMARRJA, KRIJIMI & MENAXHIMI I BIZNESIT";

Procesi i vendimarrjes për të qenë pjesë e akademisë, e kësaj platforme dinamike, ku vërehet gjithmonë një impenjim dhe përkushtimin maksimal, nga ana e drejtuesëve dhe stafit akademik, përkthehet në një mënyrë që zgjedhja juaj të përmbushë pritshmëritë tuaja sipas nevojave që keni.

Natyrshëm lind pyetja, çfarë do të përfitoj ndryshe dhe cilat janë risitë që kjo lëndë ofron? Sa do të më shërbejë në të ardhmen, sa të rëndësishme janë aftësitë menaxheriale dhe cilat janë teoritë më bashkëkohore për krijimin e një biznesi të ri? Si mund të integrohem personalisht në drejtim të anës profesionale dhe cilat janë hapat e suksesit?

Fazat e integritimit për të pasur një biznes të suksesshëm në të ardhmen?

Në aktualitet çfarë duhet të bëj më mirë, për të integruar dhe rritur biznesin ekzistues?

Kjo mori e pyetjeve rreth faktit të pasurit të një biznesi të suksesshëm si dhe Nevojat e tregut sot në punësimin e specialistëve të menaxhimit më të mirë të biznesit, janë gjithmonë në vëmendje të cilesive, ku kjo platformë e lëndës, pikërisht këtë ka qëllimin primar të ofrojë cilësinë, të zhvillojë dhe rrisë nivelin e njohurive dhe aftësive menaxheriale, karakteristikat dhe hapat për të qenë një menaxher i suksesshëm, etc.

Formimi i specialistëve cilesorë, me njohuri si në drejtimin teorik në bazë të literaturës më bashkëkohore dhe në mënyrë të veçantë në aftësitë praktike, në fushën e menaxhimit të bizneseve të vogla, mesme, dhe të mëdha, hallkat e ndryshme të cilat vënë në levizje një biznes.

Duke nxitur iniciativën për një sipërmarrje personale dhe të suksesshme, me risqet dhe kënaqësinë që ka ky proces, ku në qendër të vëmendjes vë krijimi i aktivitetit, I cili buron nga shumë faktorë, karakteristikat individuale psikologjike të personit, njohjen e një procesi në fushën e sipërmarrjes, nivelin e zhvillimit të tregut, mundësitë -rreziqet që ofron tregu. Si mund të rritemi në treg, dhe cilat "gjëra" mund të bëjmë më mirë, por mbi të gjitha, si ti bësh më mirë se të tjerët, të jesh gjithmonë më konkurrencial. Ky manual i fakteve bashkëkohore më të larmishme dhe niveli i eksperiencave praktike më të dobishme, krijohen diferencë dhe vlerë të shtuar.

Ajo çfarë dëshirojmë të ofrojmë dhe formojmë më të mirë së bashku, pranë akademisë Elita.

NGA
KOZETAKURTI

PËRBALLË KOLEGËVE...

Tre vjet më parë, kur më fuan të isha pjesë e panelit të intervistimit për studentët e një akademie të re që po hapej, Elita Politike (dhe që sot nuk është më e re, sepse ka krijuar një identitet të qëndrueshëm si qendër formimi profesional), e mora si çdo impenjim tjetër disa ditë, duke e trajtuar patjetër me seriozitet, por pa menduar asnjëherë se do ta dashuroja si sot. Sigurisht, atëherë nuk e dija që do të më besohej drejtimi i lëndës së oratorisë, që është kaq shumë zbatimëse, jo veëm për mua, por edhe për studentët. Në lëndën time nuk ka njerëz që flasin keq apo perceptojnë gabim; në lëndën time studentët thonë pa droje atë që mendojnë. Fundja qëllimi ky është; të zhvishemi nga komplekse të tipit: po bota si do mendojë po thamë këtë apo atë. Ata janë mësuar të më dëgjojnë mua, të dëgjojnë njëri tjetrin dhe në fund, kush ka shansin t'i shkojë deri në fund kësaj iniciative, të drejtojnë vetë një leksion të hapur, të përgatitur në mënyrë krejtësisht të pavarur, ku unë nuk jam as më shumë e as më pak një kolege e ulur në rreshtin e fundit. Kështu i kam trajtuar ata që ditën e parë; si kolege dhe jo sepse dua të fitoj simpatinë e tyre, por sepse unë e besoj gjithmonë atë që mendojë e mbi të gjitha që shpreh! Unë mbaj mend shumë studentët të Elitës Politike dhe ju them me bindje se kjo nuk është meritë e memories sime, por e performancës së tyre në orën time, apo edhe garave të grupeve për të fituar sfidat e shkollës.

Nuk e fsheh që e dua këtë profil më shumë nga të gjithë dhe kjo nuk ndodh se aty ka më të mirë se studentët e degëve të tjera, por sepse Elita Politike që e para dhe pas saj ju dha udhë degëve të tjera, përfshirë edhe Menaxhimin e Biznesit, ku më është besuar lënda e marketingut! Unë nuk jam "zysha" e fakultetit që të merr në provim dhe rrezon 75% të kursit. Ne aty me njëri tjetrin e shohim marketingun së pari si një mundësi për t'u treguar sa më shumë konsumatorëve që jemi këtu dhe ofrojmë këtë produkt. Tekstet profesionale janë patjetër të rëndësishme, por duke ardhur nga fusha të ndryshme, kemi gjetur mundësinë për ta bërë orën e mësimit më tërheqëse, më të kuptueshme dhe më pak të mërzitshme, duke bërë krahasime dhe analogji me fusha të tjera. Besoj se kjo është arsyeja që studentët tanë nuk janë nga ata që "mezi presin të bjerë zilja", përkundrazi jemi ne pedagogët që "grindemi" se i hyjmë në hak njëri tjetrit duke ngrënë minuta.

Jemi të ndërgjegjshëm të gjithë që kudo ka të shkëlqyer, shumë të mirë, të mirë dhe më pak të mirë. Edhe tek ne është kështu, por ka një ndryhim të madh: të gjithë këtu kanë ardhur me dëshirë, askush nuk u bën presion rezultatesh dhe të gjithë kanë mundësi të barabartë për t'u evidentuar njësoj. Meritat janë personale! Unë thjesht uroj jetëgjatësi, të njoh sa më shumë element, sepse prej kohësh, të shtunën time nuk e bëjnë pub-et dhe birrat, por Elitat!

NGA
ERINDI BEJKO

MENAXHIMI I FUSHATAVE ELEKTORALE

Trajtohet në të dy nivelet e degës së Elitës Politike. Në nivelin e parë, "Njohës i Politikave", menaxhimin e fushatave elektorale e kam strukturuar në koncepte të përgjithme, elemente bazike dhe pozicionim të çdo studenti në rolin e menaxherit të një fushate. Çdo detaj që një menaxheri i duhet për të qenë efektiv dhe i pakonkurrenshëm në fushatë.

Në nivelin e dytë, "Lider i Ri", lëndën e kam strukturuar në dimensionin e liderit. Studentët tashmë kalojnë në rrugën e të qenurit Lider. Gjuha e trupit, qëndrimi, fjalimi dhe gjithçka i duhet këtij personazhi.

Duhet të theksoj se, qëllimi primar i lëndës është të hedhim themelet e pikëpamjes së politikës moderne, larg luftërave të kundërshtarëve politik, që nënkupton eliminimin total të gjuhës së urretjes në fushatat elektorale, përplasjen vetëm të ideve që rrjedhoj ka ndryshimin e perceptimit të politikës nga qytetarët.

Lënda: Menaxhimin Burimeve Njerëzore

Në degën e Elitës së Biznesit, do punojmë me Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Rëndësia e studimit të kësaj lënde vjen si pasojë e prioritetit që kanë njerzit dhe traktimi i tyre në marrëdhëniet e punës. Qëllimi i lëndës është krijimi i edukatës së punës me anë të krijimit të politikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kjo e fundit nënkupton kryesisht:

- 1- Rolin e Liderit
- 2- Seleksionimin
- 3- Rekrutimin
- 4- Përgatitjen e një curriculum vitae
- 5- Formimin Profesional
- 6- Trainimet
- 7- Oraret në vendin e punës
- 8- Llojet e pagave
- 9- Ngritjen në detyrë
- 10- Transferimi
- 11- Pezullimi dhe
- 12- Shkarkimi

Gjatë analizimit të çdo pike të mësipërme, shoqërohet me praktikë në orën e mësimit ose detyra kursi.

Analizë

AKADEMIA PROFESIONALE ELITA

“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”

NGA MURAT KLOBOÇISHTA

ADMINISTRATOR “MIELL TIRANA” (ELITA E BIZNESIT)

ndryshimet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar që u votua në Parlament më datë 24 Shtator 2015. Ndryshimet ligjore që u votuan në Parlament më datë 24 Shtator 2015 Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat Tatimore, (por të pa dekretuar akoma nga Presidenti i Republikës), janë një nismë e mirë dhe e nevojshme e Qeverisë në luftën kundër informalitetit. Këto ndryshime ligjore në procedurat tatimore për të luftuar informalitetin në ekonomi, ndonëse në përgjithësi janë prituri mirë nga Biznesi, sidomos nga Biznesi i Mesëm dhe Biznesi i Madh, përsëri këto ndryshime në gjykimin tim, (por jo vetëm), mbartin në vetvete një sërë problematikash në pjesën e penaliteteve. Më konkretisht ndryshimet që janë bërë të cilat kontestohen nga Biznesi dhe që ndikojnë jo pak në ecurinë dhe zhvillimin e tij janë:

- Në Nenin 54, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “Deri në datën 31.3.2016, për të gjithë tatimpaguesit që kryejnë shitje me shumicë të mallrave të blerës, joushtues të një veprimtarie tregtare (individë), shitjet me kupon tatimor të lëshuar nga pajisja fiskale nuk duhet të tejkalojnë 10% të vlerës së tatueshme të mallrave të shitura në të njëjtën periudhatatimore të muajit të vitit të kaluar, pa përfshirë TVSH-në. Nga data 1 prill 2016, tatimpaguesit, që kryejnë shitje me shumicë të mallrave, nuk lejohen të shesin me kupon tatimor të blerës, joushtues të një veprimtarie tregtare (individë).” Të zgjerohet baza e tatimpaguesve dhe të ulen taksat”.

Ky ndryshim ligjor i ka gjetur të pa përgatitur bizneset në Shqipëri të cilët janë të licensuar pranë QKR për aktivitetin e tyre për shitje me shumicë dhe shitje me pakicë. Sipas këtij ndryshimi, bizneset tashmë duhet që të shesin vetëm me shumicë ose vetëm me pakicë. Respektimi i menjëhershëm i kuotës së shitjes në treg të lirë në masën 10% të xhiros deri më datën 31.03.2016 është pothuajse i pamundur të realizohet nga bizneset. Kjo gjë kërkon që bizneset të riformatojnë nga e para tregun e tyre të shitjes së produkteve, gjë e cila kërkon një kohë të caktuar fizike dhe njëkohësisht sjell kosto shtesë për ta.

- Në Nenin 121 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Tatimpaguesi, që shet mallra me shumicë, që mban në ruajtje, përdor apo transporton mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, dënohet me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetëmilionë lekë), konfiskim të të gjithë sasisë së mallit, që mbahej në ruajtje, përdorej apo transportohej, i pashoqëruar me dokumente tatimore dhe rivlerësim tatimor të të ardhurave për një periudhë 6-mujore. Me kërkesë të tatimpaguesit, masa e konfiskimit zëvendësohet me pagesën e menjëhershme të një gjobe, të barabartë me vlerën e tregut për të njëjtin mall. Për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, ku konstatohet se tatimpaguesi vazhdon të mbajë në ruajtje, të përdorë apo të transportojë mallra të pashoqëruara me dokumente tatimore, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin.”

- Në Nenin 124, pika 2 ndryshohet:

“Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH nga tatimpaguesi që shet mallra me shumicë dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padeklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç detyrimeve tatimore e interesave, që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji e të ligjeve specifike tatimore, me gjobë në masën 10 000 000 (dhjetëmilionë) lekë dhe rivlerësim të të ardhurave për një periudhë 6-mujore. Për çdo konstatim (verifikim) tjetër pas verifikimit të parë, sipas pikës 2, të këtij neni, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të këtij ligji, duke e kallëzuar penalisht tatimpaguesin”.

Ashpërsimin e gjobave ndaj fshehjes së të ardhurave të bërë si më sipër jo vetëm nuk ndihmon në luftën kundër informalitetit, por përkundrazi do të bëjë efektin e kundër dhe konkretisht:

- Do të detyrojë bizneset që të shkojnë drejt falimentimit, pasi niveli i gjobës është shumë i lartë dhe jo në proporcion me xhiron vjetore të biznesit. Nuk mundet të vendoset një gjobë në masën 10 milion lekë për një biznes që xhiron vjetore e ka 8.5 milion lekë. Në këto kushte biznesi do të pranojë deklarimin e falimentimit duke humbur vetëm 100.000 lekë kapitalin fillestar që ka ngurtësuar në bankë dhe do të shpëtojë kësaj gjobe absurd.
- Niveli i gjobave nuk është në proporcion të drejtë me shkëlqjen dhe dëmin ekonomik që i shkaktohet Shtetit, gjë e cila krijon një ndjenjë terrori dhe frike tek biznesi.
- Punonjësit tatimor i lihet dorë e lirë për të abuzuar me këtë nivel të lartë gjobash duke i bërë presion biznesit edhe për mangësi që nuk lidhen me evazionin fiskal, por me gabime të rëndomta të punonjësve.
- Sanksionet duhet të aplikohen në mënyrë të drejtë, pa i trajtuar bizneset si ca të nënës dhe ca të njerëks.
- Ndjekja penale e Administratorit të shoqërisë në rast përsëritje të një konstatimi për evazion fiskal sipas Nenit 131, për mendimin tim është e ekzagjeruar, pasi nuk mund të përgjigjet penalisht Administratori për çdo gabim, abuzim, apo evazion fiskal që kryhet nga punonjësit e tij me apo pa dashje. Kjo gjë bie ndesh dhe me Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale ku Administratori bën delegimin e kopetencave tek varësit dhe strukturat nën varësinë e tij dhe janë pikërisht këta që duhet të mbajnë përgjegjësinë për veprimet e tyre sipas detyrave funksionale që kanë dhe dëmit ekonomik që shkaktojnë si për shoqërinë dhe për Shtetin.

Që të ardhurat buxhetore të rriten, rruga më e drejtë nuk është ajo e rritjes së taksave por përkundrazi duke u ulur taksa mbi të ardhurat personale dhe dividentin, si dhe të ulët masa e përqindjes ndaj tatim-fitimit gjë e cila do të ndikojë në zgjerimin të bazës së tatimpaguesve.

Informalitetin luftohet me një plan efikas masash i cili jo vetëm zgjeron bazën e tatueshme dhe lufton kundër evazionin fiskal, por dhe e ndihmon Qeverinë të realizojë të ardhurat dhe të krijojë një bazë të qëndrueshme në hartimin e politikave fiskale. Në këtë prizëm, barra fiskale nuk bie vetëm mbi bizneset e përgjegjshme, por shtrihet në një rang më të

Ekonomia shqiptare

NGA LEDIA CANGA

STUDENTE ME MEDALJE ARI (ELITA E BIZNESIT)

Shqipëria, një shtet i mbyllur dikur, është vazhdimisht drejt tranzicionit të vështirë për një ekonomi më moderne të tregut të hapur. Edhe pse Shqipëria arriti të përballojë krizën globale financiare (2008) relativisht mirë, efektet e saj negative kanë vënë presion mbi ekonominë nëpërmjet çekuilibrit makroekonomik dhe një sektori financiar që i duhet vazhdimisht të përballet me disa risqe. Politikat zbutëse duket se kanë shterruar ndërkohë që një pjesë e madhe e borxhit publik afatshkurtër përmban risqet e rinovimit, shtuar kësaj të fundit, tregtinë dhe lidhjet e forta me zonën EURO që e ekspozon Shqipërinë edhe ndaj rreziqeve të jashtme. Nën këtë klimë makroekonomike, pas ngadalësimit të mprehtë të rritjes ekonomike, ekonomia shqiptare në nivel mikroekonomik duket të jetë duke përjetuar një përmirësim gradual.

Kjo është duke u nxitur nga kërkesa e sektorit privati përfituar nga besimi ipërmirësuar dhe disa përfitime të punësimit dhe bizneseve që tashmë shijojnë kushte më të mira të likuiditetit, në sajë të vendimit të qeverisë për të trajtuar detyrimet e prapambetura të saj. Në spektrin afatmesëm të Shqipërisë duket që performanca ekonomike do të fitojë zhvillim si pasojë e përmirësimit gradual të mjedisit-tëjashtëm dhe në sajë të projekteve të investimeve të huaja direkte në sektorin e energjisë. Normalisht që këto reforma duhet të mbështeten nga një politikë e duhur përzierje që përfshin lehtësim monetar dhe konsolidimin e vazhdueshëm fiskal.

Një politikë monetare akomoduese duhet garantuar duke pasur parasysh nivelin e ulët të inflacionit të çmimeve të konsumit, i cili ka mbetur në objektivin e bankës qendrore 2% -4% për dy vitet e fundit edhe pse hendeku i prodhimit, një kurs këmbimi relativisht i qëndrueshem dhe inflacioni i ulët i importit shpesh herë kanë arritur të vendosin presion mbi çmimet. Bankat e Shqipërisë, si përfaqësuesit më të denjë të sistemit të qarkullimit monetar janë ende të ngarkuar me një të përqindje të lartë e kredive të këqija dhe janë më të ndjeshëm nga goditjet për shkak se po mbajnë sasi të mëdha të obligacioneve qeveritare që mund të shkaktojnë humbje të ndjeshme për to në rast se zhvlerësohet borxhi publik. Lidhja e fortë e institucioneve financiare me borxhin e qeverisë duket se paraqet sfida të reja për këtë sistem. Niveli i i lartë i importeve në Shqipëri do të thotë se deficitin i llogarisë korente mundet të përkeqësohet më tej në vitet e ardhshme, pavarësisht se pritet rritje evazhdueshme në eksporte.

Deficitin i Jashtëm, në më shumë se 12% të PBB-së, reflekton një prodhim të ngushtë dhe të bazës së eksportit, si dhe një hendek të konsiderueshëm të lidhjes kursim-investime, e cila, për shkak të nevojave të larta për investime, duhet të reduktohet në afat më të gjatë. Hapa të rëndësishëm duhet të merren për të përmirësuar menaxhimin e financave publike dhe për të shmangur përsëritjen e detyrimeve të prapambetura, edhe pse përsëri mbetet shumë për të bërë. Përpjekjet në vazhdim janë kundrejt një rregulli fiskal për të ndërtuar besimin në lidhje me financat publike në afat më të gjatë ndërkohë që marrëveshja aktuale e vendit me FMN vepron si një spirancë afatshkurtër dhe masë kontrolli.

gjerë dhe kjo ndihmon që të merret në konsideratë një ulje e masës fiskale dhe jo rritje e saj.

Masat që duhet të merren duhet t'i orientojnë bizneset drejt formalitetit dhe duhet t'i nxisin ata që të punojnë brenda kuadrit ligjor. Një aksion i tillë nuk duhet të konsiderohet si një represion ndaj biznesit, sepse është më mirë që biznesi të vazhdojë punën dhe të paguajë atë që duhet të paguajë, se sa të mbyllë dyert e aktivitetit të tij, pasi nuk arrin dot të paguajë një gjobë që është më e lartë se xhiroja e tij vjetore. Le të shpresojmë që Presidenti i Republikës ta kthejë në Parlament këtë Ligj për tu rishikuar edhe njëherë nga Qeveria ky nivel tepër i lartë dhe aspak proporcional i gjobave, në mënyrë që të bëhet më efektiv dhe i aplikueshëm në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit. Përgatiti Murat Kloboçishta, Tetor 2015

Analizë

AKADEMIA PROFESIONALE ELITA

Punësimi i të rinjve: Problemi dhe zgjidhja

NGA ERMAL NAZIFI
AVOKAT (ELITA E BIZNESIT)

Një ndër problemet më të mëdhenj të vendit tonë, krahas korrupsionit dhe krimit të organizuar është niveli i lartë i papunësisë. Duke marrë parasysh faktin se shqipëria ka një përqindje të lartë të të rinjve, punësimi i tyre mbetet një element thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Papunësia e të rinjve është sfidë edhe më e madhe pasi që numri i të rinjve të papunë është dukshëm më e lartë se numri i të papunëve në popullatën e përgjithshme.

Sipas Institutit të Statistikave (INSTAT), normat e papunësisë rinore në vitin 2013 (15 - 29 vjeç), ishte 27.2%, ndërsa norma e papunësisë e popullatës në mes 15 dhe 64 vjeç ishte 16.4%. Në vitin 2014, vihet re një rritje të numrit të të rinjve të papunë, ku shkalla e papunësisë së popullsisë ndërmjet 15 dhe 29 vjeç është 32.5% ndërsa norma e papunësisë e popullsisë në mes të 15 dhe 64 vjeç është rritur duke arritur në nivelin e 17.9%.

Grafiku 1: papunësia në shqipëri sipas grupmoshave (2013-2014)

Ky trend negativ sipas INSTAT ka vazhduar edhe në 2015 ku shkalla e punësimit të popullsisë mes 15-29 vjeç është rritur nga 32.5% për vitin 2014, në 34.1% në tremujorin e parë të vitit 2015. Për popullsinë 15-64 vjeç ka pasur një rritje të lehtë në normën e papunësisë prej 17.9% në 17.3%.

Institucione të ndryshme ndërkombëtare si Banka Botwore, FMN, ILO, IOM etj. kanë identifikuar si një ndër problemet kryesore ekonomike të rajonit tonë mos-vënien në efikasitet të burimeve njerëzore. Në vend vihet re një mospërputhje e ofertës me kërkesën për punë, ku në disa raste mungojnë aftësitë e kërkuara nga tregu, në disa raste ka një numër shumë të madh të diplomuarish në fusha të caktuara tej mundësive të tregut. Një problem tjetër është niveli i lartë i parave që dërgojnë refugjatët apo të ardhurat në të zezë të cilat rritin pritshmëritë për nivelin e pagës duke ulur produktivitetin.

Një problem i rëndësishëm është fakti se ka një numër të madh të të rinjve të cilët mbarojnë universitetet, në të dy nivelet bachelor dhe master, por nuk arrijnë të gjejnë punë në sektorët apo profesionet në të cilat ata kanë përqendruar studimet e tyre. Në këtë mënyrë ka shumë raste që të rinjtë janë të ballafaquar me punëdhënësit që nuk i shfrytëzojnë aftësitë e tyre. Por edhe rastet kur nuk punëdhënësit nuk arrijnë të gjejnë punonjës me aftësitë e nevojshme janë të shumta. Në të dyja rastet, kjo mospërputhje dëmton kënaqësinë në punë, nivelin e pagave dhe produktivitetin e firmave.

Kjo ka cuar në një nivel të lartë të fenomenit të “rrjedhjes së trurit”, ku një numër shumë i vogël i të rinjve që emigrojnë punojnë në fushën e tyre të shkollimit.

Gjithashtu kriza ekonomike që ka prekur botën dhe rajonin tonë, kanë ndikuar në punësimin e të rinjve ku zvogëlimi i rritjes ekonomike ka cuar në një rritje të papunësisë të të rinjve.

Qeveria shqiptare e ka konsideruar papunësinë si një “emergjencë shoqërore”, dhe ka përgatitur një strategji për të trajtuar atë. Kjo strategji synon integrimin e politikave ekonomike, arsimore, profesionale dhe të nxitjes së sipërmarrjes me qëllim të përmirësimit të gjendjes.

Në mënyrë që të rritet punësimi i të rinjve është e nevojshme që të kombinohen të gjithë faktorët për krijimin e një tregu të drejtë e të ndershëm pune duke inkurajuar inovacionin dhe rritjen e përgjithme ekonomike por edhe atë personale të të rinjve.

Ekonomia shqiptare dominohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në këtë mënyrë, një politikë e integruar e cila do të nxisë zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve do të përmirësojë ndjeshëm punësimin e të rinjve. Vecanërisht nxitja e ndërmarrjeve që punojnë në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, kanë potencialin për tu bërë një motor për punësimin e të rinjve ku nuk kanë munguar rastet e suksesit të bizneseve të drejtuar nga të rinjtë.

Arsimimi formal e jo formal si dhe trajnimet profesionale kanë nevojë të koordinohen, modernizohen dhe të përshtaten me nevojat e tregut të punës e qëllimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Qeveria në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë ka detyrën që të analizojë e nxisë praktikat e mira që mund të gjenden sot në treg me anë të politikave efektive dhe transparente.

Në këtë kuadër nxitja e bizneseve të reja “start up”, bizneseve sociale, si dhe praktikave më të mira të punësimit të të rinjve më të kualifikuar nga sektori privat e public duhet të jetë një prioritet për të gjithë shoqërinë shqiptare për të siguruar një të ardhme më të mirë për vendin tonë.

...Një analizë e përciptë shtator 2013-tetor 2015

NGA DRITAN SHEHU
BIZNESMEN (ELITA POLITIKE)

Shtator 2013..., qeveria e re e sapo ardhur në pushtet, produkt i mazhorancës PS-LSI . Programi elektorale i kësaj mazhorance, e cila për hir të së vërtetës një pjesë e konsiderueshme e saj, vjen nga qeveria e kaluar, në vija të përgjithshme ishte:

-*Rimëkëmbje e ekonomisë, Rivendosje e demokracisë dhe Ribashkim me Europën, brënda mandatit të parë të qeverisë, 300 mijë vende të reja pune, 95 për qind e popullsisë do të përfitojë ulje taksash, 5 herë do të rritet financimi për bujqësinë, asnjë taksë mbi konsumatorin për miellin, bukën, qumështin, vezët dhe ilaçe, shfrytëzimi i burime natyrore, siguria- rivendosja e rendit publik, lehtësira fiskale për ata emigrantë që ngrënë biznese të reja dhe që hapin vende pune, jo militantizmit në arsim, shëndetësia falas për të gjithë, ripërtëritje e shoqërisë etj...

Për të gjitha këto mund të themi me plot gojë që jo vetëm nuk janë realizuar por disa tregues janë përkeqësuar më tej. Konkretisht “reformat” (sipas këndvështrimit tim personal këto janë masa të ashpra), e ndërmara nuk kanë sjellë asnjë rezultat në zhvillimin apo formalizimin e ekonomisë kombëtare përvece një terror si në sipërmarrje ashtu edhe në konsumator.

Situata politike si me zgjedhje parlamentare ashtu edhe ato lokale është e përfolur dhe e kontestuar në formë dhe në përmbajtje, zgjedhje kriminelësh që kërkon dekriminalizim. Pra jo vetëm që nuk ka rivendosje të demokracisë por përkundrazi deformim total të saj dhe për pasojë jo ribashkim por një distancim më të madh me europën. Sipas burimeve të INSTATIT shkalla e papunësisë në 2013 ishte në masën 16,4% ndërsa në 2014 vajti 17,9%, për grupmoshën 15-64 vjeç, pra sipas këtyre të dhënave kemi rritje të shkallës së papunësisë dhe jo hapjen e 300 mijë vendeve të reja pune sikurse u premtua. Përsa i përket uljes së taksave mund të them me bindje që vetëm aritmetika e qeverisë i kupton pasin ajo e qytetarit thjeshtë rëndon. Financimi i bujqësisë duket mësëmiri në situatën aktuale ku përmbytjet shkatërruan gjithçka pa filluar ende reshjet. Burimet natyrore përveç licensave të mëparshme, janë shtuar edhe ato të qeverisë aktuale pa asnjë leverdi në ekonominë kombëtare. Përsa i përket rendit, një terror më vete duke filluar nga kutitë e ndihmës së shpejtë deri te vjelja e gjobave me dhunë, ndërkohë që harta e hashashit ka mbuluar gjithë Shqipërinë dhe pistat e avioneve të transportit vetëm se nuk janë shenuar në *google map*. Sa për emigrantët?; ...lehtësira të jashtëzakonshme por jo fiskale thjeshtë kufitare, për tu larguar sa më lehtë nga Shqipëria (brënda 2 vjetësh të larguar më shumë se 100 mijë persona). Dështim total në arsim si në rekrutimin e arsimtarëve ashtu edhe në ligjin për arsimin..shëndetësia falas, tjetër flluskë elektorale.

Kjo është ripërtëritja e shoqërisë në dy vite qeverisje nga mazhoranca aktuale. Duke qënë se flitet shumë për reformën në drejtësi kohët e fundit dhe sipas mendimit tim kjo është thëmbra e akilit, në sistemin tonë dhe themeli i demokracisë në cdo rend demokratik dhe duke parë se politika aktuale del me propozime të veta si pozita ashtu edhe opozita, ku secila e harton sipas interesave të veta, i propozoj kryeministrit aktual që të kontraktojë një agjensi nga Anglia apo Gjeorgjia, a ku te dojë ai pasi do jetë më e besueshme dhe më e realizueshme pasi edhe kjo metodë tashmë është bërë modë. Në mos jo të huaj le të gjejnë ndonjë “DIA”...

NGA ALEKSANDER BABOCI
KËSHILLTAR BASHKIAK PARTIA “FORCA RINIA” (ELITA POLITIKE)

8 tetor 2015 ... Sheshet e të gjithë vendit të mbushura plot, Shqiptarë të bashkuar për një qëllim. Kjo ditë i kishte mbledhur shqiptarët për të mbështetur kombëtaren e tyre të zemrës EKIPIN KUQEZI. Të kenaqeshin sytë! Por a mjaftojnë vetëm ca ditë në vit të bashkohemi e të mbushim sheshet?!

11 tetor 2015 ... Sa mirë do i bënte Shqipërisë mbushja e shesheve për kauzat e vërteta të demokracisë në vend. Gjendja aktuale sot dikton lëvizjen e menjëhershme të popullsisë drejt shesheve. Këtë herë Jo për të festuar por për të Protestuar. Jo për të mbështetur kombëtaren por për të ndërtuar shtetin. Gropa e zezë në ekonomi, çmimet stratosferike të naftës, pagat më të ulëta në rajon janë vetëm disa nga arsyt pse Shqiptarët duhet të vërshojnë shesheve. Reformat në dukje të vendosura për tu kryer po bëjnë më shumë zhurmë se sa punë të vërtetë. Rasti i CEZ është i paprecedent.

Njerëz që burgosen për mospagimin e energjisë, prerje e dritave për të tjerë që kanë fatura të papaguara, deri këtu gjithçka duket në rrugë të mbarë. Shteti po reformohet! Pastaj si rrufe në qiell të hapur skandali i milionave euro të vjedhura në CEZ. Këtu reformat bien, besimi shëmbet e gjithçka vihet në dyshim.

Të “fortët” drejtojnë politikisht e duket sikur kanë gjithçka në dorë ndërsa pjesa më e madhe e popullit paguajnë dhe heshtin... Populli duhet të reagojë, të ndryshojë mendësit politike, të kuptojë që forcën më të madhe e kanë vetë në dorë dhe jo “të zgjedhurit” e tyre. E keta të fundit duhet ta marrin vesh se pushtetin jua jep populli dhe po ai mund tua marrë në çdo moment. Ditën kur të ndodh kjo Shqipëria do të bëhet! Atë ditë të gjitha sheshet e Shqipërisë kanë të drejtë të festojnë. ... Të mbushen plot e për plot se ja arritën qëllimit. Të festojnë për Shqipërinë...

aktivitete në vite



MOMENTE NGA AKADEMIJA PROFESIONALE ELITA

